



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISE

RREGULLORE E BRENDSHME E KËSHILLIT MBIKËQYRËS “SHTYPSHKRONJA E LETRAVE ME VLERË” SH.A.

Neni 1 DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Kjo rregullore përcakton rregullat e funksionimit të brendshëm të këshillit mbikëqyrës të “Shtypshkronjës së Letrave me Vlerë”, sha .

Neni 2 Baza ligjore dhe raporti me legjislacionin në fuqi

1. Kjo rregullore del në bazë dhe në zbatim të Statutit të Shoqërisë “Shtypshkronja e letrave me vlerë” SH.A., Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “ Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare”.
2. Aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë, do të kene epërsi ndaj kësaj rregulloreje dhe do të zbatohen drejtpërdrejtë në rast mospërputhje midis tyre dhe kësaj rregulloreje.
3. Në rast mos përputhjes epërsia në zbatimin e normave juridike do të respektojnë hiarkinë si vijon:
 - 3.1 Kushtetutën e RSH.
 - 3.2 Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara.
 - 3.3 Ligjet e miratuara me shumicë të cilësuar.
 - 3.4. Ligjet.
 - 3.5 Vendimet e Këshillit të Ministrave.
 - 3.6 Aktet e tjera nënligjore.
 - 3.7 Statutin e shoqërisë.
 - 3.8. Këtë rregullore.
 - 3.9 Vendimet e organeve drejtuese të shoqërisë.

Neni 3 KËSHILLI MBIKËQYRËS Të drejtat dhe detyrimet e këshillit mbikëqyrës

Keshilli mbikëqyrës është përgjegjës për funksionet e percaktuara në pikat 1 ,shkronjat ‘b’ deri në ‘g’ dhe ‘e’ dhe pikës 2 të nenit 154 të ligjit për shoqëritë tregtare:

- a) të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratorët;
- b) të përgatisë, me kërkesë të asamblesë së përgjithshme, marrjen e masave, që janë në kompetencë të kësaj të fundit, t’i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t’u marrë,

si dhe të zbatojë vendimet e asamblesë;

ç) të thërrasë mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë;

d) të kujdeset që shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;

dh) të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;

e) të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga administratorët. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë e anëtarët e këshillit mbikëqyrës për t'iu paraqitur asamblesë së përgjithshme, së bashku me një raport të këshillit të administrimit për miratim dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar;

ë) të sigurojë se auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabël të kryhet të paktën një herë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur e raporti i auditimit, drejtuar asamblesë së përgjithshme, t'u vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve të këshillit e administratorëve. Raporti i këshillit mbikëqyrës, përmendur në shkronjën "e" të kësaj pike, duhet të përmbajë edhe mendimin për raportin e auditimit;

f) të emërojë dhe të shkarkojë administratorët, të ndajë kompetencat ndërmjet tyre;

g) të përcaktojë shpërblimin e administratorëve;

Neni 4

Numri, emërimi dhe përbërja e këshillit mbikëqyrës

1. Këshilli mbikëqyrës përbëhet nga gjashtë anëtarë

2. Anëtarët e këshillit mbikëqyrës zgjidhen nga asambleja e përgjithshme me shumicën e kërkuar në pikën 2 të nenit 145 të Ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare" për një afat 3 vjecar. Anëtarët e këshillit mbikëqyrës mund të rizgjidhen.

3. Anëtarët të pavarur të këshillit mbikëqyrës vlerësohen personat, të cilët nuk kanë konflikt interesash, sipas përcaktimit të pikës 3 të nenit 13 të Ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare".

Neni 5

Zgjedhshmëria e kufizuar

1. Anëtarët e këshillit mbikëqyrës mund të zgjidhen nga radhët e aksionarëve dhe punëmarrësve të shoqërisë tregtare, si edhe nga radhët e individëve të tjerë, jashtë shoqërisë.

2. Një individ nuk mund të zgjidhet si anëtar i këshillit mbikëqyrës, nëse ai, njëkohësisht, është:

a) anëtar i këshillit të administrimit ose i këshillit mbikëqyrës në 2 shoqëri të tjera, të regjistruara në Republikën e Shqipërisë;

b) është administrator i një shoqërie mëmë ose i një shoqërie të kontrolluar të shoqërisë;

c) është administrator i një shoqërie tjetër, e cila ka si administrator ose anëtar të këshillit të administrimit një anëtar të këshillit të administrimit apo të këshillit mbikëqyrës të shoqërisë së parë.

3. Çdo emërim, i bërë në kundërshtim me pikën 2 të këtij neni, është absolutisht i



pagëleshëm. Të drejtat e palëve të treta mbrohen sipas nenit 12 Ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 " Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare".

4. Anëtarësimi në këshillin mbikëqyrës apo këshillin e administrimit të shoqërive të tjera të një grupi vlerësohet si anëtarësim vetëm në një bord.
5. Individët, që kandidojnë për t'u emëruar si anëtarë të këshillit mbikëqyrës detyrohen të informojnë menjëherë shoqërinë për çdo konflikt interesi e anëtarësie në këshillat e shoqërive të tjera.

Neni 6 Shkarkimi

1. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë, në çdo kohë, një anëtar të këshillit mbikëqyrës, me shumicë të thjeshtë votash. Kjo e drejtë nuk mund të përjashtohet nga statuti apo me marrëveshje. Paditë, që lidhen me shpërblimin e anëtarit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.
3. Këshilli mbikëqyrës, me shumicë të thjeshtë votash, mund t'i kërkojë gjykatës përkatëse të shkarkojë një anëtar, nëse ai ka shkelur detyrat e parashikuara në pikën 3 të nenit 163 të Ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 " Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare".

Neni 7 Shpërblimi

1. Anëtarët e këshillit mbikëqyrës përfitojnë pagë bazë e shpërblime shtesë, përfshirë këtu pjesë nga fitimi i shoqërisë apo të drejta opsioni mbi aksionet e shoqërisë. Paga e administratorëve mund të shtohet me shpërblime shtesë. Skema e këtyre shpërblimeve përgatitet nga këshilli mbikëqyrës dhe miratohet nga asambleja e përgjithshme.
2. Në përputhje me skemën e përmendur në pikën 1 të këtij neni dhe me gjendjen financiare të shoqërisë, shpërblimet individuale përcaktohen nga këshilli mbikëqyrës dhe duhet të pasqyrojnë, në mënyrë përshtatshme, ndarjen e detyrave ndërmjet anëtarëve, që mbajnë detyrën e administratorëve dhe anëtarëve të pavarur, që nuk janë administratorë.
3. Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, asambleja e përgjithshme mund të vendosë reduktimin, në masën e përshtatshme, të shpërblimeve, sipas pikës 2 të këtij neni.
4. Skema e shpërblimeve, e përmendur në pikën 1 të këtij neni, shpërblimet individuale, që u jepen administratorëve e anëtarëve të pavarur, që nuk janë administratorë, së bashku me një raport përefektin vjetor të këtyre skemave mbi pasurinë e shoqërisë, publikohet së bashku me pasqyrat financiare vjetore, sipas shkronjës "e" të pikës 1 të nenit 154 Ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 " Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare".

Neni 8 Funksionimi i këshillit mbikëqyrës

1. Këshilli mbikëqyrës e bazon punën e tij në këtë rregullore dhe në aktet e tjera ligjore në fuqi.
2. Këshilli mbikëqyrës i zhvillon mbledhjet 1 herë në tre muaj kur në të marrin pjesë të paktën 3 anëtarë të tij. Mbledhjet thërriten nga kryetari. Të drejtën për të thirrur mbledhjen e kanë dhe 3 anëtarë të tij ose administratori për çështje të rëndësishme .

Mbledhjet zhvillohen në selinë e "Shtypshkronjes së Letrave me Vlerë" sh.a. Në rast mospjesmarrje në 3 (tre) mbledhje të zhvilluara në mënyrë konsekuative atëherë këshilli kërkon që anëtari / kryetari të mos paguhet për një kohë të caktuar. Në rast mospjesmarrje në 6 (mbledhje) mbledhje të zhvilluara në mënyrë konsekuative atëherë këshilli kërkon largimin e anëtarit/kryetarit.

3. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut ose në ligj, vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm dhe kur për një çështje ka barazim votash, vota e kryetarit mbizotëron. Anëtari i Këshillit mbikëqyrës mund të shprehur votën me shkresë, me telefon apo me mjete të tjera të komunikimit elektronik, me përjashtim të rasteve kur një anëtar i këshillit ka kundërshtime për këtë mënyrë vendimmarrjeje. Anëtar i Këshillit mbikëqyrës nuk ka të drejtë votë nëse mbikëqyrës duhet të marrë vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) faljen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

3.1 Humbja e të drejtës së votës zbatohet edhe ndaj personit të me autorizuar.

4. Këshilli mbikëqyrës zgjedh midis anëtarëve kryetarin dhe nënkryetarin e tij. Zgjedhja bëhet me shumicë të thjeshtë të anëtarëve pjesëmarrës. Nënkryetari ushtron tagrat e kryetarit, kur ky i fundit është në pamundësi për t'i kryer ato personalisht. Administratori nuk mund të zgjidhet kryetar i këshillit mbikëqyrës.

5. Zhvillimi i mbledhjeve të këshillit mbikëqyrës regjistrohet në një procesverbal, i cili nënshkruhet nga kryetari dhe mbajtesi i tij. Procesverbali përmban vendin dhe datën e takimit, emrat e pjesëmarrësve, rendin e ditës, një përshkrim për çështjet e diskutuara e vendimet e marra. Parregullsitë për mbajtjen e procesverbalit nuk kanë si pasojë pavlefshmërinë e vendimeve të marra. Secili anëtar ka të drejtë të marrë një kopje të procesverbalit.

6. Këshilli mbikëqyrës mund të krijojë komitete të posaçme, të përbëra nga anëtarët e vet, për të përgatitur mbledhjet apo vendimet ose për të mbikëqyrur vënien në zbatim të vendimeve të këshillit, sidomos ato të lidhura me veprimtarinë e administratorëve, shpërblimin e tyre dhe auditimin e librave e të regjistrimeve kontabël. Secili komitet duhet të përbëhet në shumicën e vet nga anëtarë të pavarur, që nuk janë administratorë.

7. Puna e Këshillit mbikëqyrës ndihmohet nga Sekretari i Këshillit i cili emërohet nga Këshilli mbikëqyrës me shumicë të thjeshtë i cili është përgjegjës midis të tjerash edhe për mbajtjen e procesverbalit të mbledhjeve dhe për përmbushjen e detyrave të tjera që i ngarkon Këshilli mbikëqyrës ose dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 9

Detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësia

1. Përveç sa parashikohet në ligji për detyrimin e besnikërisë, anëtarët e këshillit mbikëqyrës detyrohen:

- a) të kryejnë detyrat e tyre, të përcaktuara në ligj ose në statut, në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë, në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së saj në mjedis;
- b) të ushtrojnë kompetencat, që u njihen në ligj ose në statut, vetëm për arritjen e qëllimeve, të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojnë në mënyrë të përshtatshme çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojnë dhe të mënjanojnë rastet e konfliktit, të pranishme apo të mundshme, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

MINISTRIA E
TREGTARISE
DHE EKONOMISE

d) të garantojnë miratimin e marrëveshjeve, sipas pikës 3 të nenit 13 të Ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”;

h) të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Anëtarët e këshillit mbikëqyrës përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, me përjashtim të rasteve kur veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim, në bazë të hetimit e vlerësimit të mjaftueshëm të informacioneve dhe lidhet, në mënyrë të arsyeshme, me qëllimet e shoqërisë tregtare.

3. Anëtarët e këshillit mbikëqyrës, që veprojnë në kundërshtim me detyrat dhe shkelin standardet e kujdesit, të përmendura në pikat 1 e 2 të këtij neni, janë të detyruar t'i shpërblejnë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga shkeljet, si dhe t'i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratorët apo anëtarët e këshillit mbikëqyrës kanë barrën e provës, për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator dhe/ose anëtar i këshillit mbikëqyrës, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratorët dhe anëtarët e këshillit mbikëqyrës janë të detyruar t'i shpërblejnë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kryejnë veprimet e mëposhtme:

- a) u kthejnë aksionarëve kontributet;
- b) u paguajnë aksionarëve interesa apo dividendë;

5. Dispozitat e pikës 6 të nenit 151 Ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “ Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare” zbatohen edhe për paditë, që rrjedhin nga pikat 3 e 4 të këtij neni. Këto padi duhet të ngrihen brenda 3 vjetëve nga kryerja e shkeljes apo zbulimi i saj.

Neni 10 Miratimi dhe hyrja në fuqi

- 1. Kjo rregullore miratohet nga Këshilli Mbikëqyrës.
- 2. Rregullorja hynë në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Mbikëqyrës.

Miratuar në Tiranë, më 16/10/2018

